

ANILA OMARI

**VËSHTRIM SINKRONIK I NJË DUKURIE DIAKRONIKE:
TRAJTIMI I SOTËM LEKSIKOGRAMATIKOR I TË
ASHTUQUAJTURVE ‘MBIEMRA RELIKTORË’ TË SHQIPES**

Siç na dëshmojnë studimet historiko-gjuhësore të shqipes¹, paravendosja (prokliza) është një dukuri relativisht e vonë dhe ka lindur në proceset sintaksore nga prapavendosja (enkliza). Si një dukuri e paravendosjes, nyja e përparme është shfaqur më vonë se e prapmja në sistemin nominal të shqipes. Nyja e prapme i takon periudhës parahistorike të shqipes, ndërsa e përparmja është formuar në periudhën paraletare dhe është zhvilluar shkallë-shkallë, nëpërmjet përsëritjes sintaktike të nyjës së prapme². Çabej sjell dëshmi të shumta të përdorimit të mangët të nyjës te mbiemri në dialektet arkaike të shqipes, në onomastikë e në tekstet e vjetra shqipe, të mbështetura edhe me shembuj nga pjesë të ndryshme të ligjëratës, si mbiemri, përemri, numërori, ku historikisht nuk është përdorur nyja³. Të gjitha këto argumente tregojnë se, në një fazë më të vjetër, mbiemri nuk përdorej me nyjë dhe po ashtu pjesorja dhe, ashtu si dhe në gjuhë të tjera, edhe në shqipen kufijtë e pjesores me mbiemrin dhe të mbiemrit me ndajfoljen, nuk kanë qenë të prera, as për nga forma as për nga funksioni⁴. Kjo ka ndodhur në një fazë kur, mbas rënies së mbaresave të vjetra të eptimit, pjesë të ndryshme të ligjëratës u barazuan e u njësuat, dhe pas kësaj gjuha zhvilloi mjete të reja për diferencimin e tyre, edhe nëpërmjet nyjës së përparme. Për një periudhë të lashtë të shqipes, Çabej mbështet mendimin e Boppit që adverbi dhe mbiemri nuk ndryshojnë në mes tyre nga forma⁵. Prirja për një diferencim sa më të madh funksional të të dy pjesëve të

¹ E. Çabej, “Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe”, BUSHT SSHSH, nr. 3, 1963, f. 79-90.

² E. Çabej, “Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike”, SF, nr. 4, 1970, f. 3-15; ribotuar në Studime Gjuhësore IV, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 345.

³ E. Çabej, “Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe”, art. i cit., f. 80-89. Në mbështetje të këtij mendimi mund të sjellim dëshmi të tjera gjuhësore qoftë nga të folmet jugore, qoftë nga dialektet veriore të shqipes. Në fjalorin e Marko Boçarit (1809) hasen mbiemra pa nyjë si edhe gjinore pa nyjë të përparme, si: *unazë mirë, kafshë keqe, njeri mirë, dorëzë kordhësë, marr rrogë muajit* (6c) (shih. A. Klosi, “Hyrje: një thesar gjuhësor që fjeti 150 vjet”, në *Netët pellazgjike të Karl Reinholdit. Tekste të vjetra shqipe të Greqisë*, transkriptuar e shpjeguar nga Ardian Klosi, f.37).

⁴ E. Çabej, “Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe”, BUSHT SSHSH, nr. 3, 1963, f. 82-83, 88-89.

⁵ F. Bopp, *Das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, Jena, 1854, f. 459; E. Çabej, “Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe”, art. i cit., f. 89. Khs. edhe vërejtjen e G. Weigandit se “mbiemri pa artikull shërben si ndajfolje” dhe se arsyeja

ligjëratës solli paravendosjen e nyjës te mbiemri por edhe shtesën e një elementi fundor në formë prapashtesash të ndryshme.

Në shqipen e vjetër, të shekujve XVI-XVII, ndeshen raste të shumta kur mbiemrat, sidomos në funksion predikativ, dalin pa nyjë të përparme dhe nga ana formale nuk dallohen nga ndajfolja ose nga pjesorja. Funksioni predikativ është ai ku dallimi midis mbiemrit dhe ndajfoljes është edhe më i papërcaktuar, pasi siç dihet nga gramatikat,⁶ përcaktori kallëzuesor ka lidhje të dyanshme, nga një anë me emrin në rolin e kryefjalës/kundrinës dhe nga ana tjetër me foljen në rolin e kallëzuesit. Vetë emërtimi i tij “përcaktor kallëzuesor” tregon marrëdhënien e tij të ndërmjetme si përcaktor i një emri dhe si rrethanor i një foljeje-kallëzues, dhe në rrethana të ndryshme, ai mund të priret herë nga njëra anë, herë nga tjetra. Sipas M. Totonit, lidhja me foljen shpjegon zhvillimin e nuancave rrethanore, sidomos te mbiemri, i cili, duke treguar tiparin e emrit në kohën e kryerjes së veprimit të shprehur nga folja, afrohet kuptimisht me ndajfoljen⁷. Për këtë arsye gjuhëtarët shohin vështirësi të mëdha dallimi të përcaktorëve kallëzuesorë nga rrethanorët⁸.

Në shqipen e vjetër gjendja paraqitet e ngjashme me atë të gjermanishtes së sotme⁹, në kushtet sintaksore kur në funksionin kallëzuesor paraqiten në të njëjtën formë leksema që mund t’u takojnë tri pjesëve të ndryshme të ligjëratës: pjesorja e pazgjeruar me plotësa¹⁰, ndajfolja ose mbiemri.

Në literaturën tonë të specializuar këto lloj leksemash, që hasen edhe në shqipen e sotme dhe përbëjnë një problem ende të diskutueshëm për gramatikat shqipe, janë trajtuar si forma reliktoze të mbiemrave sot të nyjshëm¹¹. Studimet historiko-gjuhësore kanë vënë re se nyja ka ardhur duke u shtrirë gjithmonë e më shumë në përdorim, dhe, sidomos te pjesorja, ky zhvillim vijon edhe sot¹², siç dëshmojnë studimet e shqipes së sotme¹³.

pse te mbiemri ka -ë dhe dhe te ndajfolja jo, është thjesht fonetike, *Albanesische Grammatik*, 1913, f. 47, shih A. Dhrimo, “Mbi disa çështje...”, art. i cit., f. 59, shën. 27.

⁶ M. Totoni, “Përcaktori kallëzuesor”, *Studime Filologjike*, nr. 3, 1976, f. 88-89.

⁷ M. Totoni, “Përcaktori kallëzuesor”, *Studime Filologjike*, nr. 3, 1976, f. 89-90.

⁸ F. Plank, “Prädikativ und Koprädikativ”, *Zeitschrift für germanistische Linguistik (ZGL)*, 13, 1985, f. 184.

⁹ Në gjermanishte në funksionin e kallëzuesorit mbiemri ka një formë të përbashkët me ndajfoljen. Leksema përkatëse nëpër gramatikat zakonisht trajtohet si mbiemër. Shih Oda Buchholz, “Kallëzuesori në gjuhën shqipe (në krahasim me gjermanishten)”, në: *Seminari IX për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë 1984, f. 57.

¹⁰ Shih F. Agalliu, “Pjesorja në gjuhën shqipe”, punim i cit., f. 186.

¹¹ Ali Dhrimo, “Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme letrare”, *SF*, nr. 1, 1969, f. 58-66; Po ai, *Për shqipen dhe shqiptarët I*, Infbotues, Tiranë, 2008, f. 41-50.

¹² Po ai, po aty, f. 88.

Mjafton të sjellim për krahasim gjendjen e përdorimit të autorët e vjetër me atë të shekullit XIX të Kristoforidhi për të njëjtin kontekst:

Buzuku: 13v88-89 *Bekuom* je ti endër grāt, e *bekuom* frujtitë e barkut tit;

Bogdani: II 15 11 *Bekuem* je ti përmbi gjithë grat, e *bekuem* është frujti i barkut tyt;

Kristoforidhi: *E bekuarë* je ti ndë mest të gravet, edhe *e-bekuarë* është pem' e barkut t'ënt (Ungjilli pas Llukajt, 1 43).

Shtimi i përdorimit të nyjës mund të vihet re edhe ndër autorët e vjetër, nga Buzuku të Bogdani. Autorët më të vjetër të shqipes, Buzuku e Budi përdorin më shumë trajta pa nyjë sesa Bogdani.

Një grup nga këto leksema, për vlerësimin kategorial të të cilave gramatikanët e shqipes nuk janë në një mendje, janë ato që tregojnë një cilësi, tek e cila kufiri midis vetisë dhe gjendjes nuk është shumë i prerë¹⁴, siç janë leksema të tipit *gjallë, shëndoshë, sëmure*. Sh. Demiraj dhe A. Dharmo, duke qenë edhe historianë të gjuhës, i trajtojnë si mbiemra këto leksema në funksion predikativ¹⁵. Ndryshe mendojnë F. Agalliu¹⁶ e M. Totoni¹⁷, të cilët, duke u nisur nga pikëpamja e pastër sinkronike, i shohin si ndajfolje që tregojnë gjendje. M. Totoni mendon se në pikëpamje gramatikore këto leksema në ndërtimet *mbeti shkretë, mbeti gjallë, e gjeta shëndoshë e mirë* nuk lidhen me kryefjalën/kundrinën pasi nuk janë rezultat i shpërbërjes së një togfjalëshi emëror dhe nuk mund të jenë gjymtyrë të një togfjalëshi emëror. Në këtë mënyrë ato nuk karakterizohen nga lidhja dyanësore, pra nuk funksionojnë si përcaktorë kallëzuesorë¹⁸. Sipas tij, ndajfolja nuk mund të funksionojë si përcaktor kallëzuesor. Këtë argument ai përdor edhe përse i përket mbiemrave reliktorë sipas vështrimit të A. Dharmos, pra mendon se këto fjalë, përveç se

¹³ “përdorimi i mbiemnit participor, që duket se asht i rrallë në gjuhën e të folmes, u bā i shpeshë në gjuhë të shkrimit (prej influencës, si duket, të gjuhëve neolatine) dhe u fut me të madhe në shkrimet e në veprat e kohëve të reja si një formë letrare”, A. Xhuvani, “Pjesorja në shqipet”, në *Studime Gjuhësore*, Tiranë, 1956, f. 206. Në të njëjtin përfundim ka arritur edhe F. Agalliu, i cili ka vënë re se në veprat e shkrimtarëve që qëndrojnë më afër gjuhës popullore, si Ali Asllani, Jakov Xoxa, Sotir Andoni ndërtimet me pjesore janë shumë më të dendura sesa në standardin e sotëm, ndërsa në letërsinë e viteve ‘60 vihet re shtrirja e përdorimit të mbiemrit foljor nga pjesorja, më tepër si një prirje e vetë gjuhës sesa si ndikim i gjuhëve të huaja, khs. F. Agalliu, “Pjesorja në gjuhën shqipe”, vep. cit., f. 189.

¹⁴ O. Buchholz, “Kallëzuesori në gjuhën shqipe (në krahasim me gjermanishten)”, art. i cit., f. 60.

¹⁵ Shih Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II, f. 266; A. Dharmo, art. i cit., f. 58, 78.

¹⁶ F. Agalliu, “Mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe”, në *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, UT, Tiranë, 1988, f. 75.

¹⁷ M. Totoni, “Përcaktori kallëzuesor”, art. i cit., f. 92.

¹⁸ M. Totoni, art. i cit., f. 92.

nuk kanë kategoritë gramatikore karakteristike për mbiemrin, ato nuk mund të hyjnë në përbërjen e një togfjalëshi emëror, prandaj nuk mund të lidhen me emrin në funksionin e kryefjalës a kundrinës, por vetëm me foljen. Përkundrazi, për A. Dhrimon fakti që çon peshë në përcaktimin e këtyre lloj fjalëve si mbiemra e që i dallon nga ndajfoljet është se ato tregojnë një tipar të sendit e jo të veprimit, madje ato mund të tregojnë edhe një gjendje, vështuar kjo më gjerë si tipar cilësor i një sendi, por gjithmonë të sendit e jo të proceseve¹⁹. Kështu ai vë theksin në aspektin semantik e sintaksor të fjalës, duke mos absolutizuar formën e saj.

Meqenëse në gjermanishten standarde, po ashtu si në shqipen e vjetër, nuk luan rol forma morfologjike në togfjalëshat mbiemërorë në funksione predikative, një autor bashkëkohor si F. Plank kur është fjala për dallimet mes përcaktorëve kallëzuesorë dhe rrethatorëve i sheh ato jo aq në të dhënat morfosintaksore sesa në rregullat e lidhjeve semantike, dhe dallimin nuk e mban si relevant nga ana sintaksore. Në këtë vështrim ai mendon se rrethatorët, si një lloj i marrëdhënive sintaksore, duhen trajtuar si përcaktorë kallëzuesorë (kopredikativë)²⁰.

Ne pajtohemi me këtë qasje metodologjike që niset nga përmbajtja semantike e lidhjet semantiko-sintaksore të fjalës dhe, për situatën e shqipes së vjetër, priremi t'i shohim si mbiemra leksemat predikative pa nyjë që shprehin tipar të sendit. Në qoftë se na duhet të përdorim kriterin e zbrërthimit të togfjalëshit emëror, këtë mund ta zbatojmë për shqipen e vjetër. Kemi dy fjali nga Buzuku: *dialëtë* tem anshtë ata qi anshtë *gjall* 055v47, dhe: dani *djalëtë e gjallë* për vjedmis 055v57; në të njëjtin kontekst (Gjykimi i Salomonit, 1Mbretërit 3 16-28). Togfjalëshi emëror *djalëtë e gjallë* zbrërthehet në fjalinë *dialëtë* tem anshtë ata qi anshtë *gjall*. Në përdorimin predikativ del trajta pa nyjë dhe e pazgjeruar e mbiemrit.

Në studimet e shqipes së sotme mbizotëron qasja sinkronike dhe mbi këtë bazë është kriteri morfologjik ai që vlen për dallimin mbiemër/ndajfolje apo pjesore/mbiemër prejpjesor, pasi ajo që i dallon qartë mbiemrat e nyjshëm në shqipe është pikërisht nyja e përparme, sot e përgjithësuar në gjuhë²¹. Si rrjedhim, në fjalorët e gramatikat e sotme leksemat *gjallë*, *shëndoshë*, *sëmurë* si relike të mbiemrave pa nyje në përdorim predikativ trajtohen si ndajfolje: *jam gjallë*, *mbeti gjallë*, *mbahet gjallë*; *qofsh shëndoshë*, *shkoj shëndoshë*, *kthehem shëndoshë*; *jam sëmurë*, *ra sëmurë*. Por edhe mes këtyre leksemave ka nuanca kuptimore dhe lidhje me fjalë të tjera në fjali që kushtëzojnë lidhje të ndryshme sintaksore: me kryefjalë/kundrinën ose me kallëzuesin foljor.

¹⁹ Po ai, po aty, f. 48.

²⁰ F. Plank, "Prädikativ und Kopradikativ", art. i cit., f. 184.

²¹ Shih p.sh. Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II, USHT, Tiranë, 1967, f. 266.; E. Hysa, "Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe", *SF* 1970, nr. 3, f. 47-48.

Leksema *shëndoshë* mbart kuptime më të qarta ndajfoljore sesa të tjerat e këtij tipi dhe këtë diferencim mund ta ndjekim në shkrimet e vjetra shqipe. Për shkak të kuptimit leksikor dhe lidhjeve me folje të caktuara, ajo paraqet tipare që shkojnë drejt diferencimit kategorial ndajfolje/mbiemër. Në faza më të vjetra të shqipes kjo leksemë paraqiste edhe ndryshime formale sipas funksioneve në fjali: në përdorim predikativ del pa nyjë dhe e pazgjeruar me mbaresa, ndërsa në përdorimin si përcaktor i thjeshtë mbiemëror shfaqet gjithmonë nyja dhe mbaresa fundore (p.sh. *shko shëndosh* vs. *është i shëndoshë*).

Këto leksema diferencohen edhe kuptimisht, pasi ato të grupit të parë që dalin formalisht të ngurosur kanë më fort kuptimin “i pacenuar”= it. “salvo, integro” që ka it. *sano*, ndërsa ato të grupit të dytë, me nyjë dhe mbaresë, kanë kuptimin “i shëndetshëm”= it. “sano”. Ky kuptim i dytë ka një përbërës semantik plotësues të cilësisë: jo vetëm që “është i pacenuar” por “gëzon shëndet të plotë”. Në gjuhën e sotme është diferencuar mirë kuptimi i kësaj lekseme nëpërmjet krijimit të një derivati të ri mbiemëror “i shëndetshëm”. Në shqipen e vjetër kuptimet e leksemës *shëndosh*- dallohen mirë që në fjalorin e Frang Bardhit: 1) *shëndosh* “salvus” 140 20; “sanus” 141 18; “sospes” 156 27 dhe 2) *i shëndoshë* “saluber” 140 10; “salutaris” 140 15; “valens” 178 28. Në gjuhën shqipe është pikërisht përdorimi predikativ që ka sjellë këtë diferencim kuptimor të këtyre leksemave. Në italishte, ku nuk bëhet dallim midis përdorimit atributiv e predikativ të mbiemrit, por në çdo rast ai përshtatet me emrin, mbiemri *sano* i përmban të dy kuptimet. Në shqipe në përdorim predikativ ajo që ka rëndësi për kuptimin është informacioni i thjeshtë për tiparin “i pacenuar”, “jo i sëmurë” të gjendjes së subjektit, dhe kjo ndodh për faktin e kufizimit kohor që ka tipari i shprehur nga leksema predikative. Në përdorimin atributiv tipari që shpreh leksema mbiemërore është i lidhur ngushtë me emrin që përcakton pa asnjë lloj kufizimi kohor; në këtë përdorim ka dalë historikisht edhe nyja e përparme e mbiemrit me përsëritje sintaktike të nyjës së pasme, si tendencë për përforcim të shprehjes me një lloj hiperkarakterizimi gjuhësor²² dhe njëkohësisht nga nevoja për diferencimin funksional të mbiemrit dhe ndajfoljes²³. Në këtë funksion përforcohet karakteri mbiemëror i leksemës përcaktuese nëpërmjet nyjës së përparme. Në rastin konkret leksema përmban informacion shtesë për cilësi të tjera (“i fortë, i qëndrueshëm etj.”) që plotësojnë kuptimin e mbiemrit *i shëndoshë*. Në këtë mënyrë shihet se si përdorimi sintaksor i fjalëve ka bërë e bën të mundur

²² E. Schwyzer, Sprachliche Hypercharakterisierung. Akademie der Wissenschaften in Kommission bei W. de Gruyter, Berlin 194.

²³ Khs. E Çabej, “Kontributi i shqipes në lidhjen gjuhësore ballkanike”, në: *Studime Gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 345.

formimin e pjesëve të ligjëratës. Në shqipen e sotme tashmë janë diferencuar këto përdorime deri në formimin e dy pjesëve të ndryshme të ligjëratës.

Leksema *gjallë* përkundrazi anon drejt kuptimit kategorial të mbiemrit. Foljet që shoqërojnë zakonisht këtë leksemë në funksion predikativ janë folje të gjendjes (*mbetem, qëndroj, mbahem*) që hyjnë në tipin e foljeve atelike ose të vazhdimësisë, dhe, meqë vetë leksema ka kuptimin leksikor të një gjendjeje dhe kjo gjendje është e zgjatur në kohë, duket sikur ajo përcakton (plotëson) foljen. Në fakt leksema *gjallë* tregon gjendjen si tipar cilësor i një emri, që është kryefjala/kundrina. Kur shoqërohet me folje të tjera telike ose të çastit del më e qartë lidhja sintaksore jo me foljen por me emrin në funksion kryefjale/kundrine. Nga shqipja e vjetër sjellim disa shembuj nga Bogdani me folje të çastit: e përbini *gjall* (l'inghiotti vivo) I 143 2; ka me u pam *gjall* dvekëtarësh (sarà veduto vivo dalli mortali) I 175 1; u duk atyne *gjall* të tretënë ditë mbas mortijet së tinaj (apparve loro vivo il terzo giorno...) II 37 18. Në shqipen e sotme kemi fjalinë *e kapën gjallë* ku fjala predikative nuk ka ndonjë ndryshim semantik dhe lidhesh sintaksore në krahasim me fjalinë *e kapën të gjallë*; në të dy rastet ajo ka semantikë mbiemërore dhe përcakton gjendjen si tipar cilësor të kundrinës së shprehur me trajtë të shkurtër përemërore. Rasti i parë është një mbiemër "reliktor" pa nyjë që nga pikëpamja e sotme klasifikohet si ndajfolje thjesht për hir të kriterit morfologjik. Natyra kategoriale mbiemërore e këtyre leksemave pa nyjë e pa mbaresa del e qartë në disa ndërtime ku ato përdoren si përcaktor predikativ²⁴ i një emri të prirë nga parafjala *me*, si gjymtyrë e dytë e një fjalie, të tipit: *Mbeti jetim me baba gjallë; dëgjonte me gojë hapët*.²⁵

Grupi i leksemave me përmbajtje semantike të ndërmjetme midis vetisë dhe gjendjes, në shqipen e vjetër ishte më i gjerë dhe përfshinte, përveç fjalëve *gjallë, shëndoshë, sëmunë/sëmutë*, edhe të tjera që në përdorim predikativ dalin pa nyjë, si *verbëtë, shurdhëtë, dëlir, lir, fëshitir*. Në shqipen e sotme këto leksema bëjnë pjesë në kategori të ndryshme leksikogramatikore: *verbër* e *dëlirë* ekzistojnë vetëm si mbiemra të nyjshëm, pasi nuk përdoren më në funksion predikativ pa nyjë; përkundrazi, *shurdhër* përdoret në mënyrë të figurshme si gjymtyrë predikative në shprehje si *na la shurdhër, mbetëm shurdhër*, të cilat kategorizohen nëpër fjalorë si ndajfolje edhe pse nuk përcaktojnë veprimin e foljes. Kjo fjalë gjatë përdorimit me kuptim të

²⁴ M. Totoni rastet që Stefan Prifti i cilëson si "plotësor kallëzuesor për gjymtyrë të dytë", siç janë mbiemrat në ndërtimet e tipit *me fytyrë të tmerruar/ ... me sy të zgurdulluar*, i sheh si përcaktorë të lidhur drejtpërdrejt me emrin, jo si përcaktorë kallëzuesorë, khs. "Përcaktori kallëzuesor", SF, nr. 3, 1976, f. 105-106. Si rrjedhim në togfjalëshat parafjalorë të përmendur në vijim *me baba gjallë* etj. gjymtyra e dytë është përcaktor atributiv, pra mbiemër.

²⁵ Shih A. Dhrimo, *Për shqipen dhe shqiptarët*, vep. cit., f. 49.

figurshëm ka marrë edhe tipare ndajfoljore duke krijuar sinonimi me *dobët, mbytur*, në bashkëlidhje me folje që shprehin veprimin e një tingulli a zëri, si *jehon, shushurin*. Leksema *vështirë* në përdorim predikativ pa nyje trajtohet si ndajfolje: *Është vështirë. E patëm vështirë. Vështirë të kthehet sonte. Sëmure gjithashtu merret si ndajfolje në përdorimet jam sëmure, ra sëmure*, por rastet kur shoqërohet me fjalë përcaktuese: *jam sëmure nga zemra, ra sëmure në shtrat* mbeten jashtë këtij kategorizimi.

Mungesa e nyjës së mbiemrave në përdorim predikativ ka bërë që në gramatikat e gjuhës shqipe të pranohet edhe ndajfolja si mjet shprehjeje i kallëzuesit emëror me këpujën *jam*, gjë që nuk gjen përgjegjëse në gjuhët e tjera evropiane.

Mbiemrat që tregojnë ngjyra janë cilësorë të mirëfilltë dhe nuk kanë ndryshime semantike nëse përdoren me nyjë ose pa nyjë. Këta lloj mbiemrash kanë mbetur edhe sot në disa përdorime në trajtën e paepituar, zakonisht të përsëritur: *kuq kuq, verdha verdha, bardhë si bora, kuq si molla, skuadra kuq e zi* etj. Në shqipen e sotme kriteri formal i nyjës i ka detyruar hartuesit e fjalorit të klasifikojnë deri edhe mbiemrat e ngjyrave në kategorinë e ndajfoljes kur dalin pa nyjë. FGJSSH ka *bardhë* si ndajfolje (*u bë bardhë në fytyrë*), por jo *kuq*, ndërsa dy mbiemrat e bashkërenditur homogjenë i ka njëfjalëzuar në mbiemrin kompozitë të panyjshëm *kuqezi*.

Leksemat *lum* e *mjerë*, që në shqipen e vjetër janë gjymtyrë predikative (khs. p.sh. Bogdani II 72 3 tha Jezu Krishti Pjetrit, *lum* je) në shqipen e sotme, tashmë të ngurosur, trajtohen si pjesëza (FGJSSH) apo pasthirrma²⁶. Në këtë mënyrë shmanget një inkoherencë e mundshme për të klasifikuar si mbiemër një trajtë pa nyjë të një mbiemri të nyjshëm. Por ky klasifikim ka lënë mënjanë rastet si *lumja unë, mjera unë*, që pas gjase janë konsideruar jonormative.

Nëse kemi të bëjmë me leksema participiale që në tekstet e vjetra dalin pa nyjë, atëherë çështja shtrohet nëse ato duhen klasifikuar si **pjesore apo mbiemra**. Kur janë të pazgjeruara me përcaktorë, në funksion kallëzuesor këto pjesore anojnë edhe nga ndajfolja. Në shqipen e sotme rrethi i pjesoreve që përdoren si ndajfolje ka ardhur duke u zgjeruar²⁷. Gramatikanët nuk janë në një mendje për përkatësinë kategoriale të këtyre formave. I.D. Sheperi (Gram. 122, shën. 3) dhe O. Myderrizi (Gram. 273) i trajtojnë ato si ndajfolje mënyre në rastet *punofsh gëzuar, shkoi gëzue, hecte zbathë*. Sh. Demiraj, përkundrazi, nuk i pranon si ndajfolje këto trajta, por si pjesore. Ai mendon se janë ndajfoljëzuar vetëm ato pjesore që nuk përdoren me kuptimin e tyre të zakonshëm, e si rrjedhim kanë ndryshuar kuptimin e tyre kategorial, p.sh.

²⁶ Gramatika e Gjuhës Shqipe II, Tiranë, 1997, f. 173, 197.

²⁷ E. Hysa, "Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe", SF, nr. 3, 1970, f. 49.

format në ndërtimet *flas hapur*, *shkoqur*, *shtruar*. Ndërsa kur pjesorja përdoret në funksion kallëzuesor nuk është e ndajfoljësuar²⁸.

Në FGJSSH është pasqyruar qëndrimi i M. Totonit, i cili, duke u mbështetur në analizën semantike të trajtave të pjesoreve në krahasim me kuptimet e foljes përkatëse, nuk i pranon si fjalë të ndryshme “pjesoret” në përdorimet *E gjeta derën hapur* dhe *flas hapur*, dhe përfundon se mes tyre ka një bosht të vetëm kuptimor, që i lidh si kuptime të së njëjtës fjalë²⁹. Në të njëjtën linjë me qëndrimin e tij për fjalët *gjallë*, *shëndoshë* etj. ai edhe “pjesoret” pranë një foljeje, kur ndërkëmben me mbiemrin pjesor përkatës, i sheh si ndajfolje, pasi shprehin një veprim si karakteristikë të një veprimi ose gjendjeje, nuk mund të zgjerohen me gjymtyrë të tjera, përveç se me ndajfolje sasive, dhe kryejnë funksionin e rrethanorit. Ai nuk i pranon këto forma si përcaktorë kallëzuesorë, duke u nisur nga mungesa e treguesve morfologjikë që të shprehin lidhjet e tyre me emrin, dhe nga fakti se nuk janë rezultat i shpërbërjes së një togfjalëshi emëror³⁰.

Ky qëndrim nisët nga rrafshi i pastër sinkronik i analizës gjuhësore dhe kriteret në radhë të parë morfologjike të përcaktimit të pjesëve të ligjëratës. Pavarësisht se këto forma të ngurosur mund t’i klasifikojmë si pjesore, funksionet dhe semantika mbiemërore e tyre janë të qarta³¹. Fjalorët e shqipes së sotme (FGJSSH 1980, FGJSH 2006) në rastet e ngjashme i kanë trajtuar si ndajfolje pjesoret *hapur*, *mbyllur*, *lidhur*, *varur*, *ulur*, *zhveshur* etj. jo vetëm në ndërtimet predikative të tipit *dera mbeti hapur*, *e gjeti dyqanin mbyllur*, *i la punët varur*, por edhe në disa togfjalësha që konsiderohen si togje të leksikalizuara, si *me gojë hapur (hapët)*, *me ballë hapur*, *me sy mbyllur*, *me duar lidhur*, *me buzë varur*, *me kokë ulur*, *me shpatë zhveshur* etj. Këto janë trajtuar në një lemë me ndajfoljet e mirëfillta në ndërtimet e tipit *foli hapur*, *eci zbathur*, *rrri ulur*, *fle zhveshur*. Ndërsa forma reliktoze pa nyjë e mbiemrit foljor *gëzuar* (khs. Buzuku: e përherë itëni *gëzuom* 046v27, Bogdani: *Vote Mri Madalena gjithë gëzuem* II 133 10) në FGJSSH trajtohet si pasthirmë, edhe në përdorimin predikativ *qofsh gëzuar*, që tashmë është ngurosur në një shprehje frazeologjike.

Për mendimin tonë problemin e shtron drejt F. Agalliu, që e njeh funksionin predikativ të pjesores të rasteve kur ajo ka mundësi të ndërkëmbet kurdoherë me mbiemrin foljor dhe kur është e pazgjeruar me plotësa. Pamundësinë e ndërkëmbimit e përcakton si kriter për kalimin e tyre në klasën e ndajfoljeve. Kalimin e pjesoreve në ndajfolje e mundëson pikërisht

²⁸ Sh. Demiraj, “Rreth ndajfoljësimit të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit parafjalë + emër”, *SF*, nr. 1, 1970, f. 140.

²⁹ M. Ttoni, “Përcaktori kallëzuesor”, art. i cit., f. 95 v.

³⁰ Po ai, po aty, f. 96-97.

³¹ Shih dhe A. Dharmo, *Për shqipen dhe shqiptarët*, I, f. 47.

funksioni predikativ dhe këtë kalim ai e sheh si një proces të gjallë dhe aktiv. Disa pjesore kanë kaluar përfundimisht në klasën e ndajfoljeve, ndërsa të tjera përdoren në të njëjtën kohë edhe me vlerë foljore në kontekste të caktuara³².

Në shqipen e shekullit XVI-XVII kriteri morfologjik e humbet rëndësinë e vet për përcaktimin e pjesëve të ligjëratës, prandaj duhen përdorur kriteret të tjera për vlerësimin kategorial të leksemave participiale. Kriteret që vijnë në vështrim janë kriteri semantik dhe kriteret sintaksore, si: funksioni i fjalës në fjali, marrëdhëniet e saj sintaksore me kryefjalën/kundrinën apo me foljen, lidhjet e saj me fjalë të tjera përcaktuese, shoqërimi apo jo me fjalë shkalle.

Për sa i përket ndajfoljësimit të pjesoreve, në shqipen e vjetër gjendja është ende në fillimet e kësaj dukurie. Në këtë kohë janë ndajfoljësuar vetëm një numër i vogël pjesorësh, si leksema me origjinë pjesore *çelë* që mbulon kuptimet e leksemave të sotme “hapur”, “haptas”, “qartë”. Pjesoret e tjera ndeshen me vlerë mbiemërore ose ndajfoljore vetëm në përdorime të caktuara. Ndryshimi i kuptimit kategorial të fjalëve të veçanta dhe kalimi në një kategori tjetër leksikogramatikore erdhi gjatë lëvrimin të gjatë në letërsi të gjuhës shqipe. Ky është një proces në vijim dhe ende në ditët e sotme diskutohet për natyrën kategoriale të disa leksemave me origjinë pjesore.

Situatën e shqipes së sotme ku përdorimi sintaktik i një pjese të ligjëratës ka sjellë diferencime që kanë çuar deri në krijimin e kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore, e ilustron më së miri përfundimi i Hermann Paulit: “...për ndarjen e zakonshme në pjesë të ligjëratës [...] Ka një numër të madh shkallësh të ndërmjetme, falë të cilave bëhet i mundur një kalim i butë nga njëra klasë në tjetrën. ...Nëse ndjekim këto kalime, atëherë sqarojmë edhe shkaqet që kanë shkaktuar në zanafillë një diferencim të pjesëve të ligjëratës”³³.

BURIMET

- A. KLOSI (bot.), *Netët pellazgjike të Karl Reinholdit. Tekste të vjetra shqipe të Greqisë*, mit Transkription und erklärenden Ergänzungen von Ardian Klossi, K&B, Tiranë 2005.
- A. OMARI (ed.), *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum*, kritische Edition, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Mësonjëtorja, Tiranë 2005.
- B. DEMIRAJ (bot.), *Dictionarium latino-epiroticum (Romae 1635) per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime françeskane, Shkodër 2008.
- Buzuku Missale*. On the basis of the facsimile editions by Namik Ressuli, Il "Messale" di Giovanni Buzuku, Città del Vaticano: Biblioteca Apostolica

³² F. Agalliu, “Pjesorja në gjuhën shqipe”, art. i cit., f. 186-187.

³³ H. Paul, *Prinzipien der Sprachgeschichte*, (V Auflage), Max Meyer Verlag, Halle, 1920, f. 355.

- Vaticana, 1958 and Eqrem Çabej, Meshari i Gjon Buzukut (1555), I-II, Prishtinë: Rilindja 1987, entered by Wolfgang Hock, Berlin 2000-2002; TITUS version by Jost Gippert, Frankfurt a/M, 9.3.2003
- E. ÇABEJ (bot.), *Meshari" i Gjon Buzukut (1555)*. Botim kritik, Pjesa e parë – Hyrje dhe transliterim, Pjesa e dytë - Faksimile dhe transkribim fonetik, Tiranë, 1968.
- G. SVANE (bot.), *Peter Budi, Dottrina Christiana (1618)*. With a transcription into modern ortography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus 1985.
- G. SVANE (bot.), *Peter Budi, Rituale Romanum (1621)*. *Peter Budi, Speculum Confessionis (1621)*, With a transcription into modern ortography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus 1986.
- K. KRISTOFORIDHI, Konstandin Kristoforidhi, Shoqëria Biblike Shqiptare, King James Version, *Dhjata e Re në krahasim*, Shoqëria Biblike Shqiptare, Tiranë 2005.

BIBLIOGRAFI

- A. DHRIMO, "Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme letrare", *SF*, nr. 1, 1969, S. 49-70.
- A. DHRIMO, *Për shqipen dhe shqiptarët I*, Infbotues, Tiranë 2008.
- A. KANANAJ, *Funksionet e rrethanorit në gjuhën shqipe*, punim doktrate i mbrojtur pranë UT, Tiranë, 2013.
- A. KLOSI, 2005: "Hyrje: një thesar gjuhësor që fjeti 150 vjet", në: *Netët pellazgjike të Karl Reinholdit. Tekste të vjetra shqipe të Greqisë*, me transkriptim dhe shënime shpjeguese nga Ardian Klosi, K&B, Tiranë, 2005, f. 9-46.
- A. XHUVANI, "Pjesorja në shqipet", në: *Studime Gjuhësore*, Tiranë 1956.
- CGEL *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, 2001.
- E. ÇABEJ, "Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike", *SF*, nr. 4, 1970, f. 3-15; ribotuar në: *Studime Gjuhësore IV*, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 335-346.
- E. ÇABEJ, "Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe", *Buletin i USHT, Seria Shkencat Shoqërore*, Tiranë 1963, nr. 3, f. 69-101.
- E. HYSA, "Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe", *SF* nr. 3, 1970, f. 19-68.
- E. PAÇO, "Pjesorja në veprën e Bogdanit", *SF*, nr. 3, 1981, f. 75-86.
- E. SCHWYZER, *Sprachliche Hypercharakterisierung*. Akademie der Wissenschaften in Kommission bei W. de Gruyter, Berlin 1941.
- F. AGALLIU, "Mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe", *Studime Filologjike*, nr. 4, 1970, f. 81-92; ribotuar në: *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, UT, Tiranë, 1988 f. 70-84.
- F. AGALLIU, "Pjesorja në gjuhën shqipe", *Studime Filologjike*, nr. 2, 1972, f. 53-68; ribotuar në: *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, UT, Tiranë, 1988, f. 172-191.
- F. BOPP, "Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen", *Abhandlungen der königlichen Akademie der Wissenschaften zu Berlin*, Berlin 1854, f. 459-549.

- F. PLANK, "Prädikativ und Koprädikativ", *Zeitschrift für germanistische Linguistik*, 13, 1985, f. 154-185.
- FGJSSH, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (ed. A. Kostallari), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1980.
- FGJSH, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2006.
- G. HELBIG – J. BUSCHA, *Deutsche Grammatik, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Langenscheid – Enzyklopädie Verlag, Berlin-München-Leipzig-New York 1996 (17. Auflage).
- G. WEIGAND, *Albanische Grammatik im südgegischem Dialekt*, Barth, Leipzig 1913.
- H. PAUL, *Prinzipien der Sprachgeschichte*, Max Meyer Verlag. Halle 1920 (5. Auflage).
- I. D. SHEPERI, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe sidomòs e toskërishtes* (për shkollat të mesme), shtypshkronja "Vlora", Vlorë 1927.
- K. ASHTA, *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Toena, Tiranë, 1998.
- K. BAUSEWEIN, *Akkusativobjekt, Akkusativobjektssätze und Objektsprädikate im Deutschen: Untersuchungen zu ihrer Syntax und Semantik*, Niemeyer Verlag, Tübingen, 1990.
- K. CIPO, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949.
- M. ÇELIKU, M. DOMI, S. FLOQI, S. MANSAKU, R. PËRNASKA, S. PRIFTI, M. TOTONI, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1997.
- M. TOTONI, "Përcaktori kallëzuesor", *Studime Filologjike*, Tiranë 1976, nr. 3, f. 87-112.
- O. BUCHHOLZ, "Kallëzuesori në gjuhën shqipe (në krahasim me gjermanishten)", në: *Seminari IX për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë 1984, f. 53-60.
- O. MYDERIZI, *Gramatika e Ré e Shqipes – Për shkollat e mesme, vëllimi I*, Shtypshkronja "Gutenberg", Tiranë 1944.
- S. RIZA, "Nyjat e shqipes në tekstet e pesë autorëve tanë më të vjetër", *SF*, 1983, nr. 1, f. 21-54.
- Sh. DEMIRAJ, "Rreth ndajfoljëzimit të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit parafjalë + emër", *SF*, nr. 1, 1970, S. 137-150.
- Sh. DEMIRAJ, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II, USHT, Tiranë 1967.

